

VENDIM
Nr.155, datë 2.3.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, TË MJEDISEVE
TË PUNËS TË INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS “GANI STRAZIMIRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15/c dhe 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të mjediseve të punës të Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi vetëm të mjediseve ku ushtrohet veprimtaria administrative e këtij institucioni.

3. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha